



## Piktori

Në fletët e mëdha të këtij libri të shkrimtarit italian për fëmijë Gianni Rodari, piktori i varfër, që s'ka asnjë lek për të blerë ngjyra, paraqitet si një siluetë e bardhë në sfondin gri. Nëse e nxitni fëmijën ta shkruajë këtë tekst në formë poezie, do ta shikoni se do të dalë një vjershë me strofa dhe rimë. Libri është dizajnuar në mënyrë të tillë që fjala dhe figura të krijojnë një sfond të përbashkët për dhënien e mesazhit artistik. Pasi fëmijët ta kenë shkruar poezinë me ndihmën e të rriturve, ata mund ta mësojnë atë përmendsh. Gjithashtu, duke u nxitur nga imazhet e këtij libri, ata mund të pikturojnë vetë figurat e librit, madje dhe të tjera, me të gjitha ngjyrat që kërkonte piktori: blunë, të verdhën, të gjelbrën, kafën, të kuqen. Ashtu si dhe piktori, fëmijët do ta kuptojnë se për të arritur diçka, më parë duhet ta kërkojnë brenda vetes.